

Në bazë të nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017, për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-116947/20 dt. 14.07.2020, të investitorit **Hava Vitija** për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërrimin e hapësirës banesore në hapësirë afariste, në Lagjen “Qendra” Bll. 9, Nr. 21, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizimit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 16.09.2020 lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit investitores-pronares Hava Vitija, sipas kërkesës me nr. 05 Nr.391/02-116947/20 dt. 14.07.2020, për përdorimin e ndërtesës të shndërruar nga hapësira banesore në hapësirë afariste sipas Vendimit 05 nr.351/02-0111278/18 dt.31.08.2018 për lejimin e ndërrimit të destinimit të hapësirës, e evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale O-71914059-06219-1-141-1-1-0, me sipërfaqe prej 42 m², Zona Kadastrale Prishtinë, Lagjja “Qendër, H-13, P/1”, Prishtinë.

II. Ndërtesa, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-0111278/18 dt.31.08.2018, dokumentacionit ndërtimor dhe Raportit të Inspektimit Final, nga Inspekcioni i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës.

III. Ndërtesa mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.


IV. Kjo Certifikatë shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Investitorja-pronara Hava Vitija, në Prishtinë, më kërkesën me 05 Nr. 391/02-116947/20 dt. 14.07.2020, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për hapësirën e shndërruar nga banimi në hapësirë afariste, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certificate.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar:

- Vendimin nr. 05 Nr. 351/02-0111278/18 dt. 31.08.2018 për lejimin e ndërrimit të hapësirës banesore në hapësirë afariste të ndërtesës, e evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale O-71914059-06219-1-141-1-1-0, Zona Kadastrale Prishtinë, Lagjja “Qendër, H-13, P/1”, Prishtinë, me investitor Hava Vitija nga Prishtina.

- 
- Vendim numër 05 Nr. 350-257153 të datës 21.02.2018 mbi caktimin e Kushteve Ndërtimore mbi përgatitjen e dokumentacionit ndërtimor për lejimin e ndërrimit të destinimit të përdorimit të hapësirës banesore në atë afariste.
 - Aktvendimin numër 05 Nr. 351/02-0111278/18 dt. 24.07.2018, mbi caktimin e taksës Administrative për dhënien e lejes së ndërrimit të destinimit.
 - Dëshmi mbi pagesën e taksës administrative për leje të shndërrimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
 - Raportin e mbikëqyrjes profesionale si dhe raportin e udhëheqësit të punishtes, Safet Gashi, IDA, udhëheqës i vend ndërtimit, dhe njëkohësisht mbikëqyrës për punët e realizuar gjatë shndërrimit të hapësirës.
 - Protokollet e miratuara për te gjitha fazat e ndërtimit,
 - Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve,
 - Fotografi gjatë procesit të ndërtimit,
 - Kopjet e diplomave të inxhinierëve mbikëqyrës të objektit,

Njëkohësisht nga Drejtoria e Inspektionit-Spektori i Ndërtimit përmes shkresës-Njoftim mbi inspektimin final, me nr. 09 Nr.391/02-103631/20 dt. 08.07.2020 ka arritur në Drejtori: Formulari i Inspektimit Final sipas UA. 05/2017 i plotësuar nga Drejtoria përkatëse.

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Raportin e të mbikëqyrjes profesionale dhe formularit të Inspektimit Final (shtojca 4/f) i plotësuar nga Drejtoria e Inspektionit të ndërtimit dhe pas dorëzimit të dokumentacionit nga ana e investitorit, përmes kërkesës 05 Nr. 391/02-116947/20 dt. 14.07.2020, ka konstatuar se:

Në raportin përfundimtar të inxhinierit mbikëqyrës fazave të ndërtesës si dhe matjeve gjeodezike, konstatohet se ndërtesa është realizuar në përputhshmëri të plotë me Ligin e Ndërtimit Nr. 04/L-110, projektin kryesor, Lejen e shdërrimit të destinimit 05 Nr.351/02-0111278/18 dt. 31.08.2018. Po ashtu theksohet se punët janë zhvilluar në harmoni me projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht hapësira banuese e shndërruar në hapësirë afariste, mund të përdoret.

Në Raportin e Inspektimit final të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit-Spektori i Ndërtimit, është konstatuar se të gjitha punimet në objekt janë të përfunduara. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 27 janë të aprovuara nga ana e Inspektionit të Ndërtimit.

Kërkesat e Vendimit 05 Nr. 351/02-0111278/18 të datës 31.08.2018 janë zbatuar,

Të gjitha mbetjet janë larguar nga vendi i ndërtimit dhe janë dërguar në një vend adekuat për deponimin e mbeturinave,

Masat për kursim të energjisë janë ndërmarrë.

Kjo drejtori, bazuar në raportet e prezantuara dhe konstatimet e lartcekura, vendosi që hapësira banuese e shndërruar në hapësirë afariste, mund të përdoret/shfrytëzohet, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për këtë ndërtesë.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.


Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certifikate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-116947/20 DT. 16.09.2020.**


Zyrtari:

Berim Osmanaj



U.D. Udhëheqëse e sektorit:

Mimoza Berisha Prestreshi



Drejtori:

Ardian Olluri



REPUBLIKA E KOSOVË
KOMUNA E PRISHTINËS
DREJTORIA E URBANIZMIT
DIREKSIONI ZA URBANIZIM
PRISHTINA PRISHTINE
REPUBLIKA KOSOVA

